



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

**MINISTRIA E BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT  
RURAL**

**QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE**

**PROJEKT: KËRKIM NË FERMË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Titulli i projektit: “Ndikimi i krasitjes verore në treguesit biologjik e agronomik të prodhimit në kulturën e pjeshkës Nektarina”.**

**Afati i zbatimit: Janar 2016 - Dhjetor 2017**

**Drejtues i projektit:**

**Athina Llambro  
Lumturi Xhelilaj**

**TITULLARI:**

**Dr. Aulona Veizi**

## **1. Hyrje**

### **Justifikimi i kërkimit**

Pemëtaria në vendin tonë po zhvillohet me ritme të larta, por futja e një numri të madh të kultivarëve të pemëve frutore në vendin tonë ka nxjerrë si domodoshmëri dhe futjen e teknologjive të reja për të patur një prodhim sasior e cilësor i cili të jetë konkures në treg.

Një nga teknikat e menaxhimit të ekuilibrit midis rritjes vegetative dhe prodhimit në pemëtore është dhe aplikimi i operacioneve të gjelbra. Duke qenë e lidhur me vegjetacionin, në aplikimin e saj duhet njohur mirë fiziologjia e zhvillimit të bimës. Ky operacion përfshin ndërhyrjet e hershme në lastarët në rritje me largimin e tyre, rrallimin e frutave, ndërhyrje në faza më të avancuara të rritjes së lastarëve si rrallimin e tyre, përkuljen, pincimin, përdredhjen ose unazimin e tyre. Këto operacione ndikojnë në ngadalësimin e rritjes vegetative të lastarëve të fuqishëm duke provokuar daljen e sythave lulor. Ato frenojnë një shpenzim të energjisë në një drejtim të padobishëm, duke e drejtuar zhvillimin e bimës sipas formës së përcaktuar për shfrytëzimin sa më mirë të hapësirës dhe në balancimin e shpërndarjes së asimilateve.

Përmbushja e një karte teknologjike të përcaktuar mirë nga ana e fermerit (me ndihmën e specialistit) do të bëjë të mundur arritjen e rezultateve në një kohë të shkurtër për të marrë një prodhim të bollshëm. Këtij qëllimi i shërben dhe ky kërkim në fermë, i cili u ngrit me kërkesë të shumë fermerëve pemërritës të Qarkut të Vlorës në fshatin Dukat. Përballja me tregun kërkon një prodhim të standarteve të larta, prandaj nëpërmjet zbatimit të elementëve të teknologjisë bashkëkohore të arrihet në marrjen e një prodhimi cilësor e të qëndrueshëm.

**Vendi i ngritjes së studimit:** Rrethi: Vlorë Fshati: Dukat Fermer: Feti Ferruni

**Stafi pjesëmarrës në studim dhe ekstensionistëve DB Vlorë etj.,**

**Nga QTTB-ja:**Specialistët:Athina Llambro, Lumturi Xhelilaj, Adhurim Lazaj, Ornela Boçova.

**Nga Shërbimi Këshillimor Vlorë:** Mefail Haxhiselimi, Dervish Seferi, Flamur Sinani.

## **2. Objektivi i kërkimit**

Rritja e kërkesës së tregut për një prodhim cilësor nxjerr si domosdoshmëri zbatimin e një teknologjie bashkëkohore për arritje e qëllimit final.

Për të parë ndikimin e krasitjes verore në cilësinë e prodhimit si dhe përcaktimin e prodhimit të një viti më pas u ngrit ky studim në fshatin Dukat të rrethit Vlorë.

Në këtë studim u vlerësua ndikimi i krasitjes verore në kapacitetin prodhues, cilësinë e prodhimit dhe ndikimi i saj në prodhimin e vitit pasardhës. Qëllimi i ngritjes së këtij studimi ishte të orientoj drejt fermerët që duan të mbjellin plantacione me pjeshkë e nektarinë, dhe të jenë të kujdesshën në zbatimin e teknologjisë për të patur një prodhim të qëndrueshëm për një kohë të gjatë dhe për të marrë prodhim cilësor.

## **3. Metodatat dhe materialet e përdorura**

Fillimisht, u kontaktua me DB-Vlorë, në bashkëpunim me ekstensionistët Mefail Haxhiselimi, Dervish Seferi, Flamur Sinani, u vendos që studimi të kryhet në parcelën e fermerit Z. Feti Ferruni. U synuan parcela me moshë prodhimi, mbi 4 vjeçare. Në këtë parcelë bimët ishin uniforme nga madhësia dhe nga koha e mbjelljes së tyre. U mbajtën shënime rreth tokës ku ishte mbjellë bimët me pjeshkë nektarina si dhe disa të dhëna paraprake nga fermeri (sipërfaqja, numri i bimëve të mbjellë) dhe u morën treguesit e planifikuar në metodikë.

#### 4. Ngritja e studimit

Në fshatin Dukat në parcelë e mbjellë me pjeshkë (nektarinë) studimi u krye në tre prova:

Prova e parë: pa ndërhyrje (duke lënë gjithë sasinë e lastarëve)

Prova e dytë: duke eleminuar 10% të lastarëve në të gjithë bimën

Prova e tretë: duke eleminuar 10% të lastarëve në çdo degë skeletore



**Figurë 1.** Foto nga puna e stafit

Agronomëve ekstensionist j'u vu në dispozicion dosja e projektit që përmbante projektin, kontratën, fletoren e fushës. Fermerit ju vu në dispozicion kryerja e analizave të tokës (përmbajtja e elementëve ushqyes si dhe një palë gërshtë). Kjo u realizua me fondet e projektit.

**Tabelë 1:** Të dhënat pedologjike dhe kimike të tokës

Horizonti	pH	Humusi %		N %		P ppm	
A2	7.1	1.4	V	0.118	M	2.7	V
A1	6.5	1.0	V	0.089	V	6.2	M
0-30	6.9	1.8	M	0.138	M	3.8	V

Të dhënat pedologjike të tokës u kryen në laboratorin e QTTB Vlorë

#### 5. Metodologjia

U mbajtën shënimet përkatëse mbi kohën e kryerjes së këtij operacioni dhe matjet e treguesve të përcaktuar në metodikë diametri i kurorës (D+d), matja e trashësisë së trungut, data e lidhjes së frutit si dhe koha e pjekjes së kultivarëve.

Gjatë kohës së pjekjes u morën mostrat për të analizuar. Mostrat u dërguan në laboratorin e QTTB Vlorë ku u kryhen analizat (sasinë e sheqerit të aciditetit dhe lëndës së thatë). Për çdo kultivarë u morën nga dy mostra. U bënë matjet e dimensioneve të frutit (D+d) si dhe të treguesve të tjerë të frutit si: ngjyra, forma e frutit etj.,

Monitorimi ishte vizual, me numërim e analiza. Treguesit u vlerësuan përmes matjeve e numërimeve e regjistrimit në fletore dhe kompjuterizim i të dhënave. Kompjuterizimi e përpunimi i treguesve u krye pas marrjes së gjithë treguesve.

Hartimi i raporteve progresivë e përfundimtar u realizuan konformë udhëzimeve.

#### **Baza e nevojshme materiale u sigurua nga projekti.**

Ecuria e studimit u ndoq nga specialistët e QTTB Vlorë dhe specialistët e DB Vlorë, në periudhat e përcaktura në metodikë. Ekstensionisti regjistroi në fletore fushe treguesit e

matshëm, të cilën e dorëzoi tek drejtuesi i studimit në përfundim të marrjes së të dhënave të fundit për vitet e studimit. Pas marrjes së fletores së fushës, të dhënat u kompjuterizuan, u përpunuan dhe u hartua raporti përfundimtar.

## 6. Rezultatet

### 6.1 Treguesit e fuqisë së bimës


Për matjen e vëllimit të kurorës të dhënat e para u kryen pas krasitjes kur bima sapo ka filluar aktivitetin e saj dhe matjet e dyta u kryen në muajin Nëntor kur bima është futur në qetësinë dimërore dhe rritja vjetore ka përfunduar.

U kryen matjet e dy diametrave të kurorës dhe lartësisë së bimës në të dy muajt Mars dhe Nëntor.

Për matjen e Vëllimit të kurorës u përdor formula:  $V_C = \frac{2}{3}\pi D^2/4.H$

**Tabelë 2.** Vëllimi mesatar i kurorës për dy vitet e studimit në pjeshkën Nektarinë (m<sup>3</sup>)

Provat	Mars	Tetor	
	V1m <sup>3</sup>	V2m <sup>3</sup>	Ritja%
Prova 1	8.24	10.67	29.49
Prova 2	4.15	5.95	43.37
Prova 3	5.45	8.98	64.22



**Grafikë 1.** Paraqitja grafike e rritjes së vëllimit të kurorës sipas provave.

Për treguesin e volumit të kurorës rritja më e madhe u gjet në provën e tretë (duke larguar 10% të lastarëve në çdo degë skeletore), krahasuar me provën e dytë dhe të parë.


### 6.2 Rritja e sipërfaqes së trungut

Matjet për llogaritjen e sipërfaqes së trungut u kryen në dy periudha në muajin Mars dhe muajin Nëntor. Llogaritja e sipërfaqes së rritjes së trungut u llogarit me formulën:

$$ST = 3.14(P/2\pi)^2$$


**Tabelë 2.** Sipërfaqja e rritjes së trungut

Provat	Mars	Tetor	
	D1 cm	D2cm	Rritja%
Prova 1	90.8	94.6	10.41
Prova 2	70.3	77.9	11.08
Prova 3	66.2	76.7	15.85



**Grafikë 2.** Paraqitja grafike e rritjes së sipërfaqes së trungut.

Për treguesin rritja e sipërfaqes së trungut rritja më e madhe u gjet në provën e tretë (duke larguar 10% të lastarëve në çdo degë skeletore) krahasuar me provën e dytë e të parë Peshë mesatare e frutit për dy vitet e studimi.



**Grafikë 3.** Paraqitja grafike e peshës mesatare të frutit sipas provave.

Për treguesin e peshës së frutit rritja më e madhe u gjet në provën e tretë (duke larguar 10% të lastarëve në çdo degë skeletore) krahasuar me provën e dytë e të parë

### 7. Vlerësimi i rezultateve

Nëpërmjet këtij studimi dyvjeçar u evidentua rëndësia e kryerjes së krasitjes së gjelbër pasi kjo ndërhyrje është e rëndësishme për realizimin e një raporti të mirë midis masës gjethore e asaj drunore.

1. Kryerja e krasitjes së gjelbër sipas provave nxorri në pah se në provën e tretë ku në çdo degë skeletore u hoq 10 % e masës së gjelbër tregoi se bima pati një zhvillim më të mirë dhe cilësia e frutave ishte gjithashtu më e mirë.
2. Krasitja e gjelbër ndikon në cilësinë e prodhimit, pasi bima ajroset më mirë duke ulur rrezikun e prekjes nga sëmundjet e dëmtuesit (peshë e frutit ishte më e madhe në provën e tretë).

## 8. Opinonet e fermerëve dhe ekstensionistëve

Fermerët dhe ekstensionistët përmes studimeve që ndjek QTTB-Vlorë për probleme të veçanta, siç qe edhe ky studim do të marrin rekomandimet e nevojshme për këtë proces të rëndësishëm që shpesh herë neglizhohet nga kultivuesit e pjeshkës.

## 9. Diskutime dhe konkluzione

Përmes këtij studimi u evidentua nevoja e kryerjes së operacioneve të gjelbra (krasitjes verore). Të dhënat e marra në disa vende të mbjella me pjeshkën Nektarinë tregoi se:

1. Në bimët ku u realizua krasitja verore ishin më zhvillim më të mirë dhe me prodhim më cilësor.
2. Kryerja e krasitjes verore, është një punë paraprake për krasitjen dimërore të vitit pasardhës, sepse ndihmon duke e lehtësuar punën e krasitësit.
3. Kryerja në kohë e me profesionalizëm e kësaj hallke të teknologjisë ndikon në rritjen e cilësisë së prodhimit gjë që në kushtet e sotme është e rëndësishme

## 10. Aplikimi i përgjithshëm i tyre

Është i domosdoshëm zbatimi i të gjitha hallkave të teknologjisë së kultivimit të pjeshkës për të marrë një prodhim cilësor.

## 11. Mesazhet e ekstensionit

Zbatimi me rigorozitet i hallkave të teknologjisë së kultivimit të pjeshkës për të marrë një prodhim cilësor.

## Shpenzimet financiare të kryera

Nr. i artikullit	Emërtimi i Artikullit	Plani vjetor 000/lek	Fakti 000/lek	Realizimet sipas 3 m			
				3/I	3/II	3/III	3/IV
602	Mallra e shërbime të tjera	15	15	5	10		
602.0	Materiale e shërbime zyre						
602.1	Materiale e shërbime speciale						
602.2	Analiza Toke	10	10				
602.3	Shpenzime transporti						
602.4	Shpenzime udhëtimi						
	Brenda vendit						
	Dieta	10					
<b>Totali</b>		<b>35</b>					

## 12. Përhapja (propagandimi) i rezultateve

Sugjerojmë për fermerët, me fillimin e ngritjes së parcelave me pemë frutore të kihet parasysh zbatimi korrekt i teknologjisë së kultivimit të kulturës që do mbillet duke marrë asistencë teknike nga specialistë të fushës.

### **13. Metoda**

Metoda e zbatimit të mesazhit të ekstensionit nga fermerët bazohet në marrëdhëniet e mira të ndërsjellta të DR-Vlorë dhe QTTB-Vlorë, në demonstrimin e rezultateve të studimit.

Hartimi i fletë - palosjeve, organizimet e seminareve, demonstrimeve, ditëve të fushës, filmimet e transmetimet televizive etj., nga stafi i studimit.

#### **Drejtues Projekti:**

Athina Llambro  
Adhurim Lazaj  
Lumturi Xhelilaj  
Ornela Boçova

#### **Shef i financës:**

Luljeta Malaj

#### **TITULLARI**

Aulona Veizi